L I G J
Nr.8248, datë 6.10.1997

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7777, DATË 22.12.1993 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKEN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJET NR.7788, DATË 9.2.1994; NR.7899, DATË 2.2.1995; NR.7972, DATË 26.7.1995; NR.8079, DATË 29.2.1996; NR. 8101, DATË 28.3.1996 DHE NR.8191, DATË 6.2.1997

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7777, datë 22.12.1993 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", në nenin 2 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

"- taksa për ulje - ngritjen e avionëve dhe qëndrimin e tyre në aeroport;

- taksë për mbikalimet ajrore të avionëve mbi territorin e Republikës së Shqipërisë.".

Neni 2

Në nenin 7, "Për taksat nacionale", pas shkronjës "nj" shtohen shkronjat "o" dhe "p" me këtë përmbajtje:

"o- Taksat për ulje-ngritjen e avionëve dhe qëndrimin e tyre në aeroport caktohen sipas lidhjes nr.8.

p- Taksa e mbikalimeve ajrore të avionëve mbi territorin e Republikës së Shqipërisë caktohet në masën 100 dollarë për çdo mbikalim."

Neni 3

Në nenin 8, në shkronjën "A. Për taksat nacionale", pas shkronjës "n" shtohen shkronjat "nj" dhe "o" me këtë përmbajtje:

"nj- Për taksën për ulje-ngritjen e avionëve dhe qëndrimin e tyre në aeroport 0 %

o- Për taksën e mbikalimeve ajrore të avionëve mbi territorin e Republikës së Shqipërisë 0 %".

Në nenin 8, në shkronjën "A. Për taksat nacionale", pas shkronjës "m" shtohet shkronja "n" me këtë përmbajtje:

"n- Për vjeljen e taksës për ulje-ngritjen e avionëve dhe qëndrimin e tyre në aeroport dhe të taksës së mbikalimeve ajrore të avionëve mbi territorin e Republikës së Shqipërisë ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil nëpërmjet ndërmarrjeve të saj, Albtransportit dhe Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror (ANTA).

Të ardhurat nga taksa për ulje-ngritjen e avionëve dhe qëndrimin e tyre në aeroport dhe taksa për mbikalimet ajrore të avionëve mbi territorin e Republikës së Shqipërisë të përdoren kryesisht për mirëmbajtjen dhe modernizimin e aeroportit të Rinasit ose aeroporteve të tjera."

Neni 4

Në nenin 9 shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:

"10. Përjashtohen nga pagimi i taksës për ulje-ngritjen e avionëve dhe qëndrimin e tyre në aeroport:

a) Avionët që transportojnë ndihma humanitare shtetërore dhe të shoqërive bamirëse.

b) Avionët që kryejnë detyra teknike për kalibrim pajisjesh navigacionale për llogari të

Drejtorisë së Aviacionit Civil, si dhe avionët e kërkim-shpëtimit e spitalore.

c) Avionët ushtarakë që nuk kryejnë veprime tregtare (ngarkim-shkarkim mallrash e udhëtarësh).

ç) Avionët ushtarakë që vijnë në Shqipëri në kuadrin e dërgimit të ndihmave humanitare falas për vendin tonë.

d) Avionët që vijnë për të marrë ose për të sjellë delegacione të larta shtetërore, të kryesuara nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Kryesisë së Kuvendit Popullor, Kryetari i Këshillit të Ministrave ose delegacione të larta ushtarake."

Neni 5

Lidhjet nr.2 dhe nr.5 zëvendësohen me lidhjet nr.2 dhe nr.5 që i bashkëngjiten këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1946, datë 14.10.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

LIDHJA NR.2
TAKSAT PER SHERBIMET KONSULLORE

1. Për lëshimin e pasaportave për jashtë shtetit 400 lekë
2. Për leje kalimi 100 lekë
3. Për vizë të huajve në bazë të marrëveshjeve ose në bazë të reciprocitetit -
4. Për shtetasit e shteteve, ndaj të cilëve nuk kërkohet vizë hyrje, merret taksë hyrjeje në territorin e Republikës së Shqipërisë në masën 5 USD

Shtetasit e atyre shteteve që nuk marrin taksë vize për shtetasit shqiptarë janë të përjashtuar nga pagimi i taksës së hyrjes.

5. Për lëshimin e pasaportave nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullatat 30 USD
6. Për leje kalimi të lëshuara nga përfaqësitë diplomatike 20 USD
7. Për lëshimin e certifikatave të çdo lloji, për legalizimin e tyre ose të çdo dokumenti tjetër nga përfaqësitë diplomatike apo nga përfaqësitë konsullore:

a. Për shtetasit shqiptarë jashtë shtetit 30 USD
b. Për shtetasit e huaj në bazë të reciprocitetit

8. Për zgjatjen e afatit të pasaportave nga përfaqësitë diplomatike apo nga konsullatat 10 USD
9. Për vërtetim çertifikatash ose të dokumenteve të tjera të lëshuara nga autoritetet tona për të huajt ose të lëshuara nga autoritetet e huaja zbatohet parimi i reciprocitetit. 10. Për vërtetim çertifikatash ose të dokumenteve të tjera të lëshuara nga autoritetet shqiptare për shtetasit shqiptarë:

a. Kur shërbimi kryhet nga zyra konsullore e Ministrisë së Punëve të Jashtme 100 lekë
b. Kur shërbimi kryhet nga përfaqësitë jashtë shtetit 1 USD

11. Përkthim dokumentesh nga përfaqësitë tona diplomatike 10 USD
12. Për verifikimin e dokumenteve nga përfaqësitë tona diplomatike 5 USD
13. Për akte noteriale, prokura, testamente etj. dhënë nga përfaqësitë tona diplomatike 20 USD

LIDHJA NR.8

NIVELI I TAKSAVE PER ULJE NGRITJEN E AVIONEVE DHE QENDRIMIN E TYRE NE AEROPORT

1.Taksat për ulje ngritje të avionit

				Dollarë USA
Për avionë deri në	1	ton	25	
mbi	1-2	tonë		35
mbi	2-6	tonë	70	
mbi	6-10	tonë	120	
mbi	10-20	tonë	200	
mbi	20-30	tonë	300	
mbi	30-45	tonë	400	
mbi	45-60	tonë	550	
mbi	60-80	tonë	650	
mbi	80-100	tonë	700	
mbi	100-120	tonë	800	
mbi	120	tonë	900	

2. Taksat e qëndrimit të avionëve në aeroport
(3 deri në 24 orë)

deri në	1	ton	8		
mbi	1	deri	2	tonë	12
mbi	2	deri	6	tonë	35
mbi	6	deri	10	tonë	40
mbi	10	deri	20	tonë	60
mbi	20	deri	30	tonë	80
mbi	30	deri	45	tonë	100
mbi	45	deri	60	tonë	130
mbi	60	deri	80	tonë	140
mbi	80	deri	100	tonë	150
mbi	100	deri	120	tonë	170
mbi	120	tonë			200

- Pesha bazë për pagesën e taksave të mësipërme do të konsiderohet pesha maksimale e ngritjes së avionit (MTOW).

- Kur fluturimet kryhen ditët e diela, ditët e festave zyrtare e fetare, si dhe jashtë orarit të punës së aeroportit, me përjashtim të avionëve të linjave të rregullta, taksave të mësipërme u bëhet një shtesë 50 për qind.

- Në rast se avioni që është ngritur nga aeroporti detyrohet të riulet për shkaqe të kushteve atmosferike apo të defekteve, taksat për uljen e përsëritur do të jenë 50 për qind më të ulëta.